



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës**

PROJEKT - V E N D I M

Nr. ____ Date 02/02/2021

“Për ndryshim përdorimi fondi në shlyerjen e vendimeve gjyqësore”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.32/1 prot. datë 14.01.2021:

Kërkojmë:

- I. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat të trashëguara gjatë vitit 2021 kërkojmë miratimin e shtesës së fondit për vendimet gjyqësore duke qenë në sekuestro konservative nga ana e përmbaruesve gjyqësorë:
- I. Pakësohet fondi rezervë nga granti dhe të ardhurat për strukturën **1810** në vlerën 13,000,000 (trembëdhjetëmilion) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **602** në 13,000,000 (trembëdhjetëmilion) lekë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse e Sektorit Financës
Mensur SHEHU

Drejtor Ekonomik
Lorenc CIBAKU

P/Sektorit Juridik
Elona LUSHA

KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË
Shkëlqim MURRJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Dibër

Relacion në lidhje me projekt vendimin për shlyerjen e vendimeve gjyqësore.

Në lidhje me projekt vendimin e dërguar për alokimin e fondit për shlyerjen e vendimeve gjyqësore ju bëjmë me dije se detyrimet e prapambetura të trashëguara nga Bashkia Dibër pas reformës territoriale nga ish komunat peshën kryesore e kanë zënë vendimet për shpërblim dëmi. Këto detyrime të trashëguara na kanë penguar në planifikimin e shpenzimeve buxhetore vjetore pasi udhëzimi i Ministrisë Financave na detyron që të planifikojmë shlyerjen e ketyre detyrimeve. Konkretisht Bashkia Dibër ka një detyrim për shlyerje të vendimeve gjyqësore në total vlerën prej 134,388,532 lekë të ndara:

- Detyrime të prapambetura të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për dëmshpërblim dëmi në vlerën 119,578,584 lekë.
- Detyrime të prapambetura të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim nga puna në vlerën 14,809,948 lekë.

Në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Bashkisë Dibër është kërkuar pranë Ministrisë Financave dhe Ekonomisë është kërkuar shlyerja e vendimeve gjyqësore për dëmshpërblim dëmi pasi bashkia e ka të pamundur shlyerjen e të gjithë këtij detyrimi, e cila na ka shkaktuar edhe bllokimin e llogarive të institucionit nga e përmbaruesve gjyqësorë duke na vënë sekuestro konservative. Këto detyrime janë pengesë e konsiderueshme për financat vendore, janë pengese për shpenzimet, shërbime dhe investime.

Përgjegjës Finance
Mensur Shehi

Drejtori Ekonomik
Lorenc CIBAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 78 Datë 24.12.2021


“Për ndryshim përdorimi fondi në shlyerjen e vendimeve gjyqësore”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.32/1 prot. datë 14.01.2021: Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **24.12.2021** miratoi me 16 vota pro 0 kunder 0 apstenim

Vendimosi

1. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat të trashëguara gjatë vitit 2021 kërkojmë miratimin e shtesës së fondit për vendimet gjyqësore duke qenë në sekuestro konservative nga ana e përmbaruesve gjyqësorë:
2. Pakësohet fondi rezervë nga granti dhe të ardhurat për strukturën **1810** në vlerën 13,000,000 (trembëdhjetëmilion) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **602** në 13,000,000 (trembëdhjetëmilion) lekë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli



BASHKIA PESHKOPJ
Nr. 4359 / P. 07/01/22
Në datën 07/01/22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1243/1 prot.

Peshkopi, më 31.12.2021

Lenda : Mbi verifikimin e ligjshmerise te vendimit nr.78 date 24.12.2021

Drejtuar: BASHKISË DIBER

DIBER

Në mbështetje të ligjit nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e këshillit të bashkisë Diber, Nr 78, datë 24.12.2021 "Për ndryshim perdorimi fondi per shlyerjen e vendimeve gjyqesore ", vendosa miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike të specifikuara në pjesën hyrëse të aktit administrative objekt verifikimi dhe shqyrtim.

